

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departmenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzurëve [REDACTED] nga f. [REDACTED] nga f. [REDACTED] nga f. [REDACTED] Skenderaj dhe [REDACTED] nga f. [REDACTED] Malishevë, të akuzuar senë bashkryrje kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzës së PTH-Ferizaj PP.nr. 1074-2/14 të dt. 24.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor, oral dhe publik me datën 27.12.2016, në prani të përfaqësuesit të PTH-Ferizaj Agim Kuka dhe të akuzuarëve [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe në mungesë të akzuarit [REDACTED] (I është veqaur procedura), muarr dhe shpalli këtë;

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1. [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Drenas, i lindur me [REDACTED] nga I ati [REDACTED], dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, gjendjes së varfer ekonomike, i pa punë-asistencë sociale , i martuar, prind i 6 fëmijëve me nr. personal [REDACTED] mbrohet në liri.
2. [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Skenderaj, i lindur me 1 [REDACTED] në të njejtin vend, nga I ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED], shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në Firmën „[REDACTED] - [REDACTED]“, gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal [REDACTED] kinse i pa denuar më pare, mbrohet në liri.

JANË FAJTOR

Se me datë 09.01.2014 , në kohë të pacaktuar, në fshatin Doganaj, Komuna Kaçanikut përkatësisht në gurrthyesin e „[REDACTED]“, në bashkëryrje , me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme të tjetrit, nga kamionët dhe ekskavatorët e kompanisë të cilët kanë qenë të parkuar aty kanë nxjerrë 100 litra naftë dhe kanë marrë 2 bateri (akumulator), të kamionëve, duke shkaktuar dëme në vlerë prej rreth 1.500.00 euro , sipas të dëmtuarit,-

Me këtë veprim në bashkryrje kryen veprën penale vjedhje nga neni 325 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3,41,46,50.51.75. dhe neneve 365 dhe 453 dhe 463 të KPPK-së shqipton

DËNIM ME GJOBË DHE KUSHT

1. Ashtu që të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjete)ditëve dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200.00 euro, të cilët nuk do të ekzekutohen po që se në afat prej një viti(koha e verifikimit)pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
2. Ashtu që të akuzuarit [REDAKTUAR] i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 90(nëntëdhjete)ditëve, i cili nuk do të ekzekutohet po që se në afat prej një viti(koha e verifikimit)pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 200.00 euro e cila do ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e në rast mospagese do o zëvendësohet në dënim me burg duke i llogaritur 20 euro gjobë 1 ditë burg.
3. Udhzohet i dëmtuari që kërkesen pasuroro-juridike ta realize në contest civil .
4. Obligohet i pandehuri [REDAKTUAR] që ti kompenzoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 20.00 euro, ndërsa conform neni t 453 të KPPK-së i pandehri [REDAKTUAR] lirohet nga pagesa e shpenzimeve procedural ngase është përfitues i asistencës sociale.

A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me aktin akuzues .PP/II. Nr. 1074-2/14 të datës 24.03.2015 të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] I ka ë akuzuar për shkak veprës penale në bashkryrje vjedhje nga neni 325 par 1 lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Gjykata me aktvendim procedural ka veçuar lendën penale për të akuzuarin [REDAKTUAR] conform nenit 36 të KPPK-së.

Në shqyrtimin fillestar gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarve [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] të i shpall fajtor për veprën penale që akuzohen dhe tui shqiptoj sanksion penal të paraparë me ligj. .

Të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në mbrotjen e tyre në shqyrtimin fillestar gjyqsor në tërsi e kanë pranuar kryerjen e veprës penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues dhe propozojnë që gjykata të iu shqipton denim sa më të butë.

Pasi që gjykata ka fituar bindjen se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale që iu vëhet në barrë dhe është e bindur se pranimin e kanë bërë në baza vullnetare duke u mbshtetur në nenin 248 të KPPK-së edhe në faktet dhe provat që përmbajnë akti akuzues por edhe ne

shkresat e lendes, ka gjetur se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe shqyrtimin gjyqsore e ka përfunduar pa adminstrimin e provave tjera .

Gjykata ka vlersuar se në veprimet e të akuzuarëve ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje nga neni 325 par 1 të KPK-së.për të cilat vepër penale të akuzuarit janë penalishtë përgjegjës dhe janë ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit gjykata ka marrë për bazë pranimin e fajit nga ana e të akuzuarëve, pendimin e tyre, sjelljen e mirë të tyre gjatë tërë procedures si dhe në shqyrtimin gjyqsor, kurse për bazë për llojin dhe lartsin e denimit ka marrë parashysh, efekti do arrihet edhe më këtë denim, ndërsa rrethanë rënduese se kjo veper penale është e drejtuar kundrejt të mires shoqrore që ka mbrotje ligjore.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarëve është në harmoni me shkallën e përgjegjesisë dhe peshën e vepres penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi si në dispozitiv të aktgjykimit , do arrihet qëllimi i denimit i paraparë me nenin 41 të KPK-së dhe atë efektin rehabilitues dhe pengues tek kryesit, efektin preventiv në mjedis si dhe reagimin shoqror ndaj kësaj dukurie negative dhe të ndeshkushme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures dhe udhizimin e palëve të dëmtuara është i mbshtetur në dispoziten e nenit 453 dhe 463 të, KPPK-së ,

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ


Dega në Kaçanik

P. nr. 137/15 me dt. 27.12.2016

Sek. Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtari
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi , pala e palëkundurka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.


REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA E KOSOVES
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NE KACANIK
KOSOVA
27.01.2017